

UDHËZIM
Nr. 15, datë 23.12.2024

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 11, DATË 17.4.2018, “PËR
RREGULLAT E BRENDSHME MBI MËNYRËN E EKZEKUTIMIT TË
VENDIMEVE GJYQËSORE TË MINISTRISË SË FINANCave DHE
EKONOMISË**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 510, 589, të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”, të neneve 43, 54 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 152, datë 30.5.2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Ministri i Financave,

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 11, datë 17.4.2018, “Për rregullat e brendshme mbi mënyrën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në titullin e udhëzimit, togfjalëshi “*Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë*” zëvendësohet me togfjalëshin “*ministrisë përgjegjëse për financat*”.

2. Në pikën 6, të kreut II, togfjalëshi “*çështje të pronës publike dhe*”, hiqet.

3. Pika 8, e kreut II, ndryshon si më poshtë vijon:

“8. Struktura përgjegjëse për financat, pas marrjes së dokumentacionit nga struktura përgjegjëse për ndjekjen e çështjeve gjyqësore së bashku me kërkesën e miratuar për ekzekutimin e vendimit gjyqësorë, bën verifikimin e fondeve buxhetore dhe radhës së pagesës, sipas data bazës të përgjellë nga struktura përgjegjëse për ndjekjen e çështjeve gjyqësore, dhe i paraqet nëpunësit autorizues propozimin për miratimin e kërkesës së pagesës që shoqërohet me aktin financiar, në kuadër të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

4. Në të gjithë përmbajtjen e udhëzimit, togfjalëshi “*Ministria e Financave dhe Ekonomisë*” zëvendësohet me togfjalëshin “*ministra përgjegjëse për financat*”.

5. Në aneksin 1, “*Gjurma e Auditimit për procedurat e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore*”, faqe 3, zëvendësohet me faqen 3, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCave
Petrit Malaj

